



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit /Ured Premijera/Office of The Prime Minister

DOSJA E TENDERIT

Sipas Nenit 27 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – SHËRBI ME NJË OPERATOR EKONOMIK - PROCEDURË E HAPUR

Data e përgatitjes së Dosjes së Tenderit : 18.07.2023.

Nr. i Prokurimit ¹	ZK 104	23	027	211
-------------------------------	--------	----	-----	-----

TITULLI : “Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së”

KJO DOSJE E TENDERIT PERBEHET PREJ TRI PJESËVE :

Pjesa A: Informacione për Tenderuesit;

Pjesa B: Draft Kontrata që përmban kushtet kontraktuese të cilat duhet t'i pranojë tenderuesi që merr kontratën; dhe

Pjesa C: Formulari i Tenderit, d.m.th. dokumentet që duhet t'i paraqesin tenderuesit (Formulari i tenderit krijohet në platformën E-prokurimi pasi që oferta dorëzohet në mënyre elektronike).

Kjo dosje e tenderit është përgatitur në gjuhët Shqipe, Serbe dhe Angleze

Në rast se ka mospërputhje në mes versioneve gjuhësore, versioni i gjuhës Shqipe do të mbizotëron.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Tema: “Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së”.

Ju faleminderit për interesimin e juaj për pjesëmarrje në aktivitetin e lartë përmendur të prokurimit.

Sipas kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkangjitur dokumentet, të cilat përbëjnë Dosjen e Tenderit.

Nga ju pritët që të ekzaminoni me kujdes të gjitha pjesët, nenet dhe anekset e kësaj dosjeje të tenderit dhe të pajtoheni me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

Ne, si Autoritet Kontraktues nuk pranojmë asnjë ndryshim.

Në rast të dështimit të dorëzimit të tenderin tek autoriteti kontraktues brenda afatit të caktuar në Dosjen e Tenderit, dhe/ apo nuk është pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, do të refuzohet dhe do të konsiderohet si “ tender i papërgjegjshëm”

Të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe me dorëzimin e tenderit duhet të barten nga tenderuesi, ndërsa autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura

Kjo procedure e tenderimit është e rregulluar me Ligjin e Prokurimit Publik (Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092) dhe rregullave të prokurimit të nxjerra në përputhshmëri me të.

LPP-ja dhe Rregullat e Prokurimit mund të shkarkohen nga web-faqja e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP): www.krpp.rks-gov.net.

Tenderët duhet të dorëzohen në adresën e specifikuar në pjesën A “Procedurat e Tenderimit para : **30.08.2023 ora 14:00**

Me dorëzimin e tenderit, tenderuesi pranon në mënyrë të plotë dhe pa rezervime, kushtet e veçanta dhe të përgjithshme që rregullojnë këtë kontratë të propozuar si një bazë të vetme të kësaj procedure të tenderimit.

Mirëpresim pranimin e Tenderit tuaj.

Nëse vendosni të mos e dorëzoni tenderin, do të ishim mirënjohës nëse do të na lajmëronit me shkrim, duke cekur arsyet e vendimit të juaj.

Me nderimet,

PËRMBAJTJA E TABELËS

PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT.....	4
SEKSIONI I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT.....	4
TË PËRGJITHSHME	4
KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOHEN NGA OPERATORËT EKONOMIK.....	4
PËRMBAJTJA E DOSJES SË TENDERIT	8
PËRGATITJA E TENDERIT.....	8
DORËZIMI DHE HAPJA E TENDERËVE	9
VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE.....	10
DHËNIA E KONTRATËS.....	11
SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD)	13
ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.....	16
ANEKSI 2 DEKLARATA NËN BETIM	19
ANEKSI 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST	20
ANEKSI 4 SIGURIA E TENDERIT	21
ANEKSI 5 KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË	21
ANEKSI 6. DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT	
PJESA B: DRAFT KONTRATA & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA	23
PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA	24
PJESA II E KONTRATESKUSHTET E PËRGJITHSHME	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA	31
PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT	32
PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR	32
PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT	

PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT
SEKSIONI I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT

	TË PËRGJITHSHME
1. Fushëveprimi i tenderit	<p>1.1 Autoriteti Kontraktues i cekur në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT), lëshon këtë Dosje të Tenderit për shërbimesiçspecifikohetnëSpecifikimet teknike, Aneksi I, dhe në PjesënC, Përshkrimi i Çmimeve.</p> <p>1.2 Titulli i kontratës dhe numri identifikues i këtij aktiviteti të prokurimit janë të shënuara në FDT.</p> <p>1.3 Informacioni mbi publikimin e Njoftimit të Kontratës është ishënuar në FDT.</p> <p>1.4 Tenderët duhet të dorëzohen në adresën e autoritetit kontraktues të shënuar në FDT.</p> <p>1.5 Përgjatë kësaj Dosje të Tenderit:</p> <p>a) shprehja “me shkrim” kuptohet komunikimi në formë të shkruar (p.sh. me e- mail, faks, teleks) me dëshmi të pranimit;</p> <p>b) nëse konteksti kërkon “njëjës” gjithashtu nënkupton “shumës” dhe anasjelltas;</p> <p>c) “ditë” nënkupton ditë kalendarike;</p> <p>d) ju jeni të referuar si “operator ekonomik” apo “tenderues” dhe</p> <p>e) lëshuesi i kësaj dosje të tenderit referohet si “autoritet kontraktues”.</p>
2. Qëllimi i Kontratës	<p>2.1 Klasifikimi i Përgjithshëm i Fjalorit të Prokurimit dhe qëllimi i kontratës janë të shënuara në FDT.</p> <p>2.2 Nëse kontrata është e ndare në pjesë (lote), secila pjesë mund të shprijë në dhënien e një kontrate të veçantë. Sasitë e dhëna për pjesët e ndryshme do të jenë të pandashme. Tenderuesi duhet të ofrojë tërësinë e sasisë ose të sasive të shënuara për secilën pjesë. Nëse tenderuesit i janë dhënë kontratat për më shumë se një pjesë, një kontratë e vetme mund të bëhet, duke i mbuluar të gjitha ato pjesë.</p> <p>2.3 Numri i pjesëve (lotëve) është i shënuar në FDT.</p> <p>2.4 Vlera e parashkuar e kontratës është e shënuar në FDT.</p>
3. Specifikimet teknike të detyrueshme	<p>3.1 Shërbimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit, shih Aneksin I, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, sasitë, modeletmostrat, matjet dheudhëzimet tjera.</p> <p>3.2 Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikoj tenderin.</p>
4. Variantet	<p>4.1 Përveçnëse është e shënuar ndryshe në FDT, tenderuesit nuk janë të autorizuar të dorëzojnë tender që propozon ndonjë variant i cili është në pajtueshmëri me një variant të specifikimeve teknike.</p>
5. Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	<p>5.1 Vendi i performimit të shërbimeve është e shënuar në FDT.</p> <p>5.2 Afatet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës siç është shënuar në FDT.</p>
	KËRKESAT që duhet të plotësohen nga OPERATORËT EKONOMIK
	Operatorët ekonomik duhet t`i plotësojnë të gjitha kërkesat në vijim. Çdo mos përmbushje e ndonjëres nga kërkesat do të eliminojë tenderin e tyre nga konkurrimi.
	Kërkesat e përshtatshmërisë
6. Përshtatshmëria e operatorëve ekonomik	<p>6.1 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij/saj:</p> <p>a. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues;</p> <p>b. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të këtyre të fundit; ose</p> <p>c. duke qenë në cilindo rast në një konflikt interesi, siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1.75</p>

6.2 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të fundit:

- a. është shpallur fajtorë nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikata e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP-se sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
- b. është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rende profesionale, e konstatuar nga një gjykatë kompetente;
- c. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato; ose
- d. është shpallur fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente;
- e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
- f. është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër.

6.3 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operator ekonomik:

- a. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë: (i) të falimentimit, (ii) të pranimit të urdhrit për likuidim ose përmblyllje të aktiviteteve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër;
- b. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
- c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paaftë që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
- d. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në nën-paragrafët a, b ose c të këtij paragrafi, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;
- e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga ose për një operatori të tillë ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij;
- f. aktualisht është lëndë e një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon ose redukton pagesat nga ose për operatorët e tillë ekonomik nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
- g. gjatë tri (3) viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër;
- h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar te jete jo i rëndësishëm në Kosovë;
- i. është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;
- j. ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës;
- k. ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes;
- l. nuk është shpallu fajtor me një vendim të plotfuqishëm të miratuar në përputhshmëri me Nenin 99.2 të LPP-se.

	<p>Periodhat kohore të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës.</p> <p>6.4 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik ka të drejtë pjesëmarrjeje në procedurën e prokurimit, operatori ekonomik duhet të dorëzojë dëshmitë e dokumentuara të shënuara në FDT.</p>
	<p>Kërkesat minimale kualifikuese</p>
<p>7. Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale</p>	<p>7.1 Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të shënuara në FDT.</p> <p>7.2 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik është i përshtatshëm të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese të shënuara në FDT.</p>
<p>8. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>8.1 Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat minimale ekonomike financiare të shënuara në FDT</p> <p>8.2 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale ekonomike financiare operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese të shënuara në FDT.</p>
<p>9. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p>	<p>9.1 Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat minimale mbimundësitë teknike dhe/apoprofesionale të shënuara në FDT.</p> <p>9.2 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/apoprofesionale, operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese të shënuara në FDT.</p>
	<p>9.3 Autoriteti kontraktues, me shpenzimet e tij, mund të kryejë një inspektim të operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit.</p>
<p>10. Informatat sekrete afariste</p>	<p>10.1 Nëse operatori ekonomik dëshiron që ndonjë informatë lidhur me gjendjen ekonomike /financiare dhe aftësitë teknike/profesionale të trajtohetsi informatë sekrete afariste, duhet të dorëzoj një kërkesë me shkrim duke përdorur formën e caktuar në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 3.</p>
<p>11. Krijimi i një grupi te operatoreve ekonomik</p>	<p>11.1 Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik,grupi është i detyruar të emëroj njërin nga anëtarët e grupit sioperator ekonomik kontaktues dhe duhet të prezantoj me tenderin e tij dokumentet e shënuar në FDT.</p> <p>11.2Nga një grup i tillë nukdotëkërkohehtë për të marrë përsipër ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin, por Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën, nëse një kërkesë e tillë është e nevojshme përpërmbyshjen e mjaftueshme të kontratës, të kërkojngagrupi ipërzgjedhurpër ta bërë këtë nësekontratai jepetnjë grup të tillë siparakushtë për nënshkriminekontratës.</p> <p>11.3 Operatorete ekonomik nuk janë te lejuar qe te tenderojnë ne te njëjtën kohe ne mënyre individuale dhe si anëtarë te një grupi apo si anëtarë te grupeve te ndryshme. Ne raste te tilla operatori ekonomik dhe grupi i tille do te jene te papranueshëm.</p>
<p>12. Nën-kontraktimet</p>	<p>12.1 Operatorët Ekonomikë ne tenderin e tyre duhet të deklarojnë cilëndo pjese te kontratës që Operatori Ekonomik ka për qëllim të nënkontrakttojë palën e tretë dhe te dorëzoje me tenderin e tij dokumentet e shënuara në FDT.</p>
<p>13. Sigurimi i tenderit</p>	<p>13.1 Në qoftë se shënohet në FDT tenderuesi duhet të dorëzoj, sipas të tenderit të tij, një Sigurim të tenderit.</p>

	<p>13.2 Siguria e tenderit duhet të jetë në shumën dhe për një periudhë valide siç është e shënuar në FDT, dhe mund të dorëzohet në një nga format e shënuara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) çeku të vërtetuar nga një bankë e klasit të parë; b) letër krediti, të hapur dhe të konfirmuar nga një bankë e klasit të parë; c) garancie të pakushtëzuar bankare, të lëshuar nga një bankë e klasit të parë; apo d) police e sigurimit të lëshuar nga një Kompani e licencuar e sigurimeve. <p>13.3 Nëse kërkohet Sigurimi i Tenderit dhe ndonjë tender nuk është shoqëruar menjëherë me Sigurim të konsiderueshëm të përgjegjshëm të Tenderit, tenderi dotërefuzohet si tenderi papërgjegjshëm.</p> <p>13.4 Forma e sigurisë së tenderit është e specifikuar në Aneksin 4 të kësaj dosje të tenderit.</p> <p>13.5 Autoriteti kontraktues do ta kthejë sigurinë e tenderit të depozituar brenda pesë (5) ditëve, pas ndodhjes së cilës do nga ngjarjet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) skadimi i datës së vlefshmërisë së tenderit; b) dhënia dhe hyrja në fuqi e kontratës; c) anulimi ose përfundimi i aktivitetit të prokurimit para dhënies ose hyrjes në fuqi të kontratës; d) Metërheqje të tenderit para afatit të fundit për dorëzimin e tenderit, përveç nëse është deklaruar në DT që nuk është e lejuar një tërheqje tilla. <p>13.6 Sigurimi i Tenderit mund të konfiskohet nëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Autoriteti Kontraktues cakton që operatori Ekonomik ka dorëzuar informata të rrejshme apo mashtruese; 2. Operatori Ekonomik e tërheq tenderin e tij pas datës së fundit për dorëzimin e tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit dhe 3. Operatori Ekonomik është dhënë kontratë por refuzon ose dështon: <ul style="list-style-type: none"> a) që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit; b) të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës; ose c) që të zbatoj kontratën.
<p>14. Siguria e Ekzekutimit</p>	<p>14.1 Në qoftë se është cekur në FDT, para nënshkrimit të Kontratës, tenderuesi i suksesshëm, do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues një Sigurim të Ekzekutimit.</p> <p>14.2 Sigurimi i ekzekutimit duhet të jetë në vlerën dhe për një periudhë valide siç është shënuar në FDT.</p> <p>14.3 Forma e Sigurisë së Ekzekutimit është e specifikuar në Pjesën B, Seksioni IV.</p> <p>14.4 Siguria e ekzekutimit mund të depozitohet nënjërën nga format e cekura për Sigurimin e tenderit.</p> <p>14.5 Dështimi i Operatorit të suksesshëm Ekonomik për të dorëzuar Sigurinë e Ekzekutimit të lart-përmendur ose nënshkrimit të Kontratës, dotë përbëjnë arsye të mjaftueshme për anulimin e dhënies dhe konfiskimin e sigurisë së tenderit.</p> <p>14.6 Sigurimi i Ekzekutimit do të konfiskohet në rast të:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) shkeljes së kontratës së nënshkruar, e cila i shkakton dëme materiale autoritetit kontraktues dhe/ose kërkon nga autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime materiale për përfundimin e kontratës në fjalë, dhe b) Kontrata e nënshkruar është prishur dhe shumë punëtorë kanë mbetur të papaguar, nënkontraktorët dhe / ose furnizuesit e materialeve;

	<p>14.7 Në rast se nuk ka ndodhur asnjë nga rrethanat e cekura më lart, që do të shkaktonin konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit, autoriteti kontraktues do t'i kthej fondet ose dokumentet që janë depozituar në formë të sigurisë së ekzekutimit, në pajtim me kushtet e kontratës.</p>
	<p>PËRMBAJTJA E DOSJES SË TENDERIT</p>
<p>15. Seksionet e Dosjes se Tenderit</p>	<p>15.1 Dosja e Tenderit përbëhet nga Pjesa A, B, dhe C, të cilat përfshijnë të gjitha Seksionet e prezantuar më poshtë, dhe duhet të lexohensë bashku me ndonjë Shtojcë të lëshuar në përputhje me Informacion për Tenderuesit Neni 17.</p> <p>PJESA A Procedurat e Tenderimit</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Seksioni I, Informata për Tenderuesit ● Seksioni II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) ● Anekset <p>PJESA B Kontrata</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Seksioni I, Draft Kontrata ● Seksioni II, Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK) ● Seksioni III, Kushte e Veçanta të Kontratës (KVK) ● Seksioni IV, Formulari i Garancionit të Përmbushjes ● Seksioni V, Identifikimi Financiar <p>PJESA C Forma e Tenderit</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Seksioni I, Forma e Tenderit ● Seksioni II, Përshkrimi i Çmimeve
<p>16. Sqarimet e Dosjes se Tenderit</p>	<p>16.1 Tenderuesit janë të lejuart të bëjnë një kërkesë me shkrim pran autoritetit kontraktues për informata shtesë ose sqaruese që ata mendojnë se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e tenderit të përgjegjshëm. Një kërkesë e tillë mund të bëhet me anë të përdorimit të formularit për kërkesë, shih Aneksin 5, dhe të dorëzohet tek autoriteti kontraktues në mënyrë elektronike, me shkrim ose faks. Autoriteti Kontraktues do të përgjigjet me shkrim për sqarim, me kusht që kërkesa e tillë është marrë më vonë se afati idhëne në FDT. Autoriteti kontraktues do të dërgojë kopjet e përgjigjes së tij tek të gjithë ata që kanë pranuar Dosjen e Tenderit duke përfshirë pyetjen por pa e identifikuar burimin e saj. Nëse Autoriteti kontraktues e sheh të domosdoshme që të ndryshojë Dosjen e Tenderit, si rezultat i sqarimit, atëherë duhet ta bëjë këtë sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 17 të Informatave për Tenderuesit.</p>
<p>17. Ndryshimi i Dosjes se Tenderit</p>	<p>17.1 Në çdo kohë para skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve, Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë Dosjen e Tenderit duke lëshuar një shtojcë.</p> <p>17.2 Çdo shtojcë e lëshuar do të jetë pjesë e Dosjes së Tenderit dhe do t'i komunikohet me shkrim të gjithë operatorëve ekonomik që kanë marrë Dosjen e Tenderit.</p> <p>17.3 Për t'i udhënë tenderuesve të mundshëm kohët më të mëdha për të marrë parasysh shtesën e përgatitjes së ofertave të tyre, Autoriteti Kontraktues do të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e tenderëve në përputhje me Nenin 53 të LPP-së.</p>
	<p>PËRGATITJA E TENDERIT</p>
<p>18. Gjuha e Tenderit</p>	<p>18.1 Operatorët Ekonomik mund të përgatisin dhe të dorëzojnë tenderët e tyre dhe dokumentet e lidhura në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.</p>
<p>19. Dokumentet që përbejnë Tenderin</p>	<p>19.1 Tenderi duhet të përmbajë si në vijim:</p> <p>a) Formën e Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve duke përdorur format e dhëna në Pjesën C të kësaj Dosje të Tenderit;</p> <p>b) Sigurimin e Tenderit, në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 13, nëse aplikohet;</p>

	<p>c) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 6, evidentimi i përshtatshmërisë së Tenderuesit;</p> <p>d) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 7, evidentimi i të përshtatshmërisë profesionale, nëse aplikohet;</p> <p>e) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 8, evidentimi i gjendjes ekonomike dhe financiare, nëse aplikohet;</p> <p>f) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 9, evidentimi i mundësisë teknike dhe profesionale, nëse aplikohet;</p> <p>g) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 11 dhe 12, nëse aplikohet dhe</p> <p>h) Ndonjë dokument tjetër që kërkohet në FDT.</p>
<p>20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit</p>	<p>20.1 Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës.</p> <p>20.2 Çmimet e tenderit për shërbimet e ofruara janë të fiksuara për gjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk mund të ndryshohen.</p> <p>20.3 Në qoftë se tenderët janë ofertuar për kontratat individuale (lot-e) çmimet e ofruar duhet të korrespondojnë me 100% të artikujve të specifikuar për secilën pjesë (lot) dhe 100% për sasi të specifikuar për secilin pozicion për atë pjesë (lot).</p>
<p>21. Periudha e Vlefshmërisë së Tenderit</p>	<p>21.1 Tenderët do të mbeten të vlefshme për aq kohë sa është e shënuar në FDT. Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të fillojë në datën e afatit të fundit të dorëzimit të tenderëve. Një tender që është valid për një kohë më të shkurtër, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues si jo e përgjegjshme.</p> <p>21.2 Në rrethana të jashtëzakonshme, paraskadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesi zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së tenderëve të tyre. Kërkesat dhe përgjigjet duhet të bëhen me shkrim. Nëse Sigurimi i Tenderit kërkohet ajo do të zgjatet edhe për një periudhë përkatëse. Dështimi për t'u përgjigjur kërkesës së bërë nga autoriteti kontraktues do të çojë në refuzimin e tenderit, pa konfiskim të Sigurimit të Tenderit të tij.</p>
<p>22. Vulosja dhe Shënimi i Tenderit</p>	<p>22.1 Tenderuesi duhet të përgatisë një origjinal të dokumenteve që përbëjnë tenderin, siç përshkruhet në Informatat për Tenderuesit Neni 19 dhe në mënyrë të qartë të shënojë atë "ORIGJINAL" Përveç kësaj, Tenderuesi duhet të paraqesë kopje të tenderit, në numrin e shënuar në FDT dhe në mënyrë të qartë të shënojë ato "KOPJE".</p> <p>22.2 Tenderuesi duhet të vendosë tenderin origjinal dhe çdo kopje në zarfe të veçanta dhe në anën e përparme të secilit zarf do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Shënon qartë si "Origjinal" apo "Kopje"; ● Shënon numrin e Prokurimit siç është e cekur në dosjen e tenderit; ● Shënon emrin dhe adresën e tenderuesit. <p>22.3 Zarfet pastaj duhet të mbyllen në një zarf të jashtëm që tregon vetëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Adresën e vendit të dorëzimit të tenderëve; ● Numrin e Prokurimit; ● Paralajmërim, se zarfi nuk guxon të hapet para datës dhe kohës së hapjes së tenderit; dhe ● Emrin dhe adresën e tenderuesit
<p>23. Afati i fundit për dorëzim të tenderëve</p>	<p>DORËZIMI DHE HAPJA E TENDERËVE</p> <p>23.1 Tenderët do të pranohen nga Autoriteti Kontraktues jo më vonë se data dhe koha e shënuar në FDT.</p>

<p>24. Tenderët e vonuar</p>	<p>24.1 Autoriteti Kontraktues nuk do marrë në konsideratë ndonjë tender që arrin pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Cilido tender i pranuar nga Autoriteti Kontraktues pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve do të deklarohet i vonshëm dhe do t'i kthehet tenderuesit i pa hapur.</p>
<p>25. Tërheqja , Zëvendësimi, dhe Modifikimi i Tenderëve</p>	<p>25.1 Përveç nëse është cekur ndryshe në FDT, Tenderuesi mund të tërheq, Ndërron apo Modifikoj tenderin e tij, pasi që të jete dorëzuar duke dorëzuar një shkresë me shkrim tek Autoriteti Kontraktues, e cila shkresë duhet të jete e nënshkruar siç duhet nga përfaqësuesi autorizues. Zëvendësimin përkatës ose modifikim të tenderit duhet të shoqërohen me njoftimin përkatës me shkrim. Të gjitha njoftimet duhet të jenë:</p> <p>a. të dorëzuara nëpërputhjeme Informatat për Tenderuesit, Seksioni 22 dhe përveç kësaj, zarfet përkatës, do të shënohet qartë "TËRHEQJE," "ZËVENDËSIMI," ose "MODIFIKIM"; dhe</p> <p>b. të pranohen nga Autoriteti Kontraktues para afatit të fundit të përcaktuar për dorëzimin e tenderëve.</p> <p>25.2 Tenderët e kërkuara për tërheqje duhet të dorëzohen të pa hapura tek Tenderuesit.</p> <p>25.3 Asnjë tender nuk mund të tërhiqet gjatë intervalit kohor prej të afatit të fundit të dorëzimit të tenderit deri tek skadimi i periudhës së vlefshmërisë së tenderit. Tërheqja e tenderit gjatë këtij afati do të rezultojë me konfiskimin e sigurimit të tenderit.</p>
<p>26. Hapja e Tenderëve</p>	<p>26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë hapjen e tenderit në publik në adresën, datën dhe kohën e cekur në FDT.</p> <p>26.2 Çdo tenderues ka të drejtë të ketë përfaqësuesin prezent që të vrojtaj hapjen e tenderëve.</p> <p>26.3 Nëse Tërheqjet, Zëvendësimet dhe Modifikimet janë të lejuara, së pari zarfet të shënuara "TËRHEQJE" duhet të hapen dhe lexohen me zë dhe zarfi tjetër me tender përkatës nuk duhet hapur, por t'i kthehet Tenderuesit. Nëse zarfi i tërheqjes nuk përmban kopje me " autorizim të avokatit" që konfirmon nënshkrimin e personit të autorizuar për të nënshkruar emërtet tenderuesit, atëherë tenderi përkatës do të hapet. Mandej, zarfete shënuara "ZËVENDËSIMI" do të hapen dhe lexohen me zë dhe tenderi i zëvendësuar nuk do të hapet, por kthehet tek Tenderuesi. Zarfi i shënuar "MODIFIKIM" do të hapet dhe lexohen me zë me tenderin përkatës.</p> <p>26.4 Asnjë tërheqje, zëvendësim apo modifikim i tenderit nuk do të lejohet përveç nëse njoftimi mbi tërheqjen, zëvendësimin ose modifikimin përkatës përmban një autorizim të vlefshëm për të kërkuar, tërheqjen zëvendësimin ose ndryshimin dhe është lexuar në hapjen e tenderëve. Vetëm zarfet që janë hapur dhe lexuar me zë në hapjen e tenderëve do të konsiderohen më tej.</p> <p>26.5 Të gjitha zarfet e tjera do të hapen në një kohë, duke lexuar me zë: emrin dhe adresën e tenderuesit, çmimin total të tenderit të specifikuar në formularin e dorëzimit të Tenderit dhe, kurdo që është e mundur, çmimet për njësi. Kur për arsye të jo atypëratyshme çmimet për njësi nuk mund të lexon, çmimet e tilla në çdo rast duhet të bëhen të dukshme gjatë hapjes publike për të gjithë përfaqësuesit e ofertuesve, si për shembull duke bere postimin e tyre ose duke përdorur ndonjë tjetër metode adekuate e cila garanton transparence . Në çdo rast, secila faqe e çdo tenderi financiar do të nënshkruhet gjatë hapjes publike nga një përfaqësues i një ofertuesi tjetër. Në rast të aktivitetit të prokurimit ku kriteri i shpërblimit të kontratës është tenderi ekonomikisht më i favorshëm çdo gjë që ka të beje me numra duhet të lexohet si afati i dërgesës, periudha e garancionit etj. E gjithë kjo duhet të regjistrohen në procesverbalin e hapjes së tenderëve, i cili duhet të nënshkruhet nga Zyrtari i Prokurimit dhe nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e hapjes së tenderit. Kopjet e procesverbalit në fjalë, duhet tu dërgohen menjëherë të gjithë tenderuesve.</p>
<p>VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE</p>	

<p>27. Ekzaminimi i tenderëve</p>	<p>27.1 Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Prokurimi Publik.</p> <p>27.2 Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të kësaj dosjeje të tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.
<p>28. Sqarimi i Tenderëve</p>	<p>28.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin etenderëve, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga secili Tenderues individualisht sqarim mbi tenderin e tij/saj. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili Tenderues për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP. Megjithatë, sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Secili sqarim që dorëzohet nga tenderuesin lidhjet tenderine tij dhe që nuk është në përputhje me kërkesën nga autoriteti kontraktues nuk do të konsiderohet.</p> <p>28.2 Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen vetëm me shkrim, por nuk guxon të kërket, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim.</p> <p>28.3 Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidomos ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Gabimet e korrigjuara në këtë mënyrë do të jenë të obligueshme për tenderuesin. Autoriteti kontraktues menjëherë do të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.</p> <p>28.4 Në rast të mospërputhjeve në mes çmimit për njësi dhe vlerës totale, apo fjalëve dhe figurave, çmimi për njësi dhe fjalët do të mbizotërojnë.</p>
<p>29. Përgjegjshmëria e tenderëve</p>	<p>29.1 Nëse tenderi nuk është i përgjegjshëm do të refuzohet dhe nuk mund të bëhet i tillë që të jetë në pajtueshmëri më vonë duke e korrigjuar atë ose duke e tërhequr largimin ose kufizimin.</p> <p>29.2 Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen dhe krahasohen sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në Dosjen e tenderit. Tenderuesi i cili ka dorëzuar tenderin e renditur më të lartë do t'i jepet kontrata.</p>
<p>DHËNIA E KONTRATËS</p>	
<p>30. Kriteret e Dhënies së Kontratës</p>	<p>30.1 Kontrata do të shpërblehet sipas kriterëve për dhënien e kontratës siç janë shënuar në FDT</p>
<p>31. Ankesat</p>	<p>31.1 Sipas Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, ankesa mund të dorëzohet, pa pagesë, nga cilado palë e interesuar në <u>çdo fazë</u> të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij.</p> <p>31.2 Forma standarde e ankesës mund të shkarkohet nga faqet e internetit të KRPP-së ose OSHP-së: www.krpp.rks-gov.net ose www.oshp.rks-gov.net.</p> <p>31.3 Ankesat duhet të dorëzohen në origjinal te Autoriteti Kontraktues, në adresën e specifikuar në FDT.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kurdo që ankesa ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.

- Kurdo që ankesa ka të beje me vendimin për dhënie të një kontratë brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës që i është dërguar ankuesit.
- Kurdo që ankesa ka të beje me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

31.4 Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

31.5 Të gjitha ankuesit duhet të paguajnë një tarifë për ankese në shumë sipas ligjit në fuqi së bashku me paraqitjen e një ankese në OSHP. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose të holla ekuivalente në llogarinë e krijuara nga OSHP-ja.

31.6 Për procedura të mëtejshme rreth ankesave referohuni në LPP dhe në Rregullat e Prokurimit.

SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD)

Të dhënat e mëposhtme për shërbime që do të prokurohen do të plotësojnë, shtojnë, ose ndryshojnë dispozitat e Informatave për Tenderuesin. Kurdo që paraqitet ndonjë mospërputhje, këto dispozita do të mbizotërojnë mbi ato në Informata për Tenderuesit.

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve
Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit	
Fusha e tenderit	1.1	Autoriteti Kontraktues (AK) është: Emri i AK: Zyra e Kryeministrit Adresa e AK: Ndërtesa e Qeverisë, Kati i VII. Nr. 702 Qyteti: Prishtinë Kodi Postar: 10 000 Adresa Elektronike: https://aqp.rks-gov.net/ Kontakti: Përmes platformës elektronike të prokurimit publik në Kosovë https://e-prokurimi.rks-gov.net
	1.2	Titulli i kontratës dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është: Titulli i kontratës: “Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së” Numri i prokurimit i brendshëm: ZK104 23 027 211
	1.3	Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: 18.07.2023 Versioni i plotë i njoftimit të kontratës të dërguar në KRPP mund të shkarkohet nga faqja elektronike e-prokurimi www.e-prokurimi.rks-gov.net .
	1.4	Tenderi duhet të dorëzohet në adresën e përmendur në 1.1
Qëllimi i Kontratës	2.1	Qëllimi i kontratës publike kornizë është që të përcaktohen kushtet për shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së Shërbimet përmbajnë: fushata të ndryshme informuese, reklama televizive, shërbime nëpër portale online, shtyp etj. (shih Aneksin I)
Ndarja në Lote	2.3	Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 93 00 00 00-8
Vlera e parashikuar	2.4	Vlera e parashikuar : € 200,000.00
Variantet	4.1	Variantet nuk do të autorizohen
Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	5.2	Ofrimi i shërbimeve me një mori artikujsh. Kontrata do të jetë kornizë për 24 Muaj. Sasitë janë të përafërta dhe të cilat mund të devijojnë deri në ± 30%
	5.3	Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: 24 Muaj pas nënshkrimit të kontratës.
Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	6.4	Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP Ligji Nr. 04 L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04 L-237, Ligjin Nr. 05 L-068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net . Nëse nuk ofrohen vërtetimet do të veprohet komfor Nenit 99.2 i LPP-së. <u>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</u> 1. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e ANEKSIT 2. 2. Për situatën referuar pikës 6.3 (a, b dhe d), vërtetim të lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. 3. Për situatën referuar pikës 6.3 h (tatimit), vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë (Pika 2 & 3) do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t’ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga

		tenderuesi para dhënies së kontratës dhe nuk duhet të jenë më të vjetra se tre muaj para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtyre dokumenteve, tenderi në fjalë do të refuzohet.
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1	<ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit NUI; 2. Regjistrimin e TVSH-së
	7.2	<p><u>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (certifikata e biznesit NUI); 2. Kopja e certifikatës së TVSH-së;
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1	N/A
	8.2	
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	<p>Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/apo profesionale, operatori ekonomik duhet të ofroj:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Një (1) Menaxher projekti Minimum një (1) regjisor për realizimin e produkteve mediatike - videospoteve , Minimum një (1) skenarist. Minimum tre (3) dizajnerë grafik. Minimum tre (3) kameramanë. 2. OE të ketë realizuar me sukses shërbime në realizimin e minimum pesë (5) video-reklama në tre vitet e shkuara nga data e njoftimit për kontratë.
	9.2	<p><u>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lista e kualifikimeve profesionale, master në fushën e marketingut dhe komunikimit, diplomat e noterizuara të stafit, CV-të e tyre si dhe kontratat apo para kontratat e punës. 2. Një listë që specifikon shërbimet e realizuara në fushën marketingut dhe komunikimit, duke specifikuar shumën e kontratës; datën e pranimit, raport e pranimit ose referencë.
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	<ol style="list-style-type: none"> a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke confirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. e. Te gjithë operatorët ekonomik duhet të jenë të regjistruar në platformen e E-prorkuimit. <p>Për situatën referuar pikës 11.1 a, b dhe c, OE duhet të plotësojë Deklaratën e themelimit të grupit duke përdorur formularin e dhënë në Aneksin 6.</p>
Nënkontraktimet	12.1	<ol style="list-style-type: none"> a) një deklaratë ku deklarohen nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe b) Të gjithë kontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Siguria e tenderit	13.1	Shuma e Sigurimit të Tenderit duhet të jete ne vlerë prej 3,000.00 € (tre mijë euro) për periudhë valide prej 120 ditë. Sigurimi i tenderit duhet të dorëzohet i skanuar se bashku me oferte, ndërsa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohet të dorëzohet nga tenderuesi të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Mos dorëzimi i formës origjinale të sigurimit të tenderit shpije ne zbatimin e nenit 99.2 të LPP-se. ZKM mbanë të drejtën e verifikimit të Garancionit të tenderit të dorëzuar nëpërmes sistemit së bashku me ofertë.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit do të jetë 10% e vlerës së kontratës me kohëzgjatje prej 25 muaj. ZKM mban të drejtën e verifikimit të sigurimit të ekzekutimit.
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	Deri më: 07.08.2023 ora 12:00 në mënyrë elektronike
Periudha vlefshmërisë së tenderit	21.1	Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë.
Vulosja dhe Shënimi i Tenderëve	22.1	Sipas sistemit të E-Prokurimit
Afati i fundit idorëzimit të tenderit	23.1	Deri më: 30.08.2023 në 14:00 në platformën elektronike të prokurimit publik të Kosoves. https://e-prokurimi.rks-gov.net/
Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimi i Tenderëve	25.1	Operatori ekonomik është i obliguar që ofertën të dorëzon në formë elektronike (e-prokurimi) dhe të veproj sipas E-prokuimit.
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do të bëhet me: Datën: 30.08.2023 në ora: 14:00 ne Zyrën Nr.702 në ZKM përmes platformës elektronike të prokurimit publik të Kosoves. https://e-prokurimi.rks-gov.net/
Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
Ankesat	31.3	Sipas pikës 1.1 të FDT-së.

ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE

Qëllimi i këtij aktiviteti është që të lidhet një kontratë kornizë me një Operator ekonomik (OE) të kualifikuar i cili do të ofronte shërbimet të informimit publik për nevojat e ZKM-së” sipas përshkrimit në tabelën më poshtë.

Shërbime dhe materiale informative për aktivitete të Komunikimit dhe Informimit për Fushatën e Informimit për Liberalizim të Vizave			Nr. i Porosive / 24 Muaj
1	Realizimi i video dhe audio spotit të nivelit HD me përmbajtje informuese krijuar me aktorë dhe regjisor profesional sipas koncept idesë së rekomanduar nga Autoriteti Kontraktues.	Video dhe audio- spot në kohëzgjatje 35 - 45 sec.	3
2	Realizimi i video dhe audio spotit për rrjete sociale (video për përfitimet dhe mundësitë e liberalizimit të vizave për, artist, sportist, biznese, vizita familjare (gjyshe – nip), të rinj, etj.	Video dhe audio- spot në kohëzgjatje 35 - 45 sec.	10
3	Transmetimi i video-clipeve të bëhet në kohën më të shikuar të TV (para transmetimeve të lajmeve ose menjëherë pas kohës së transmetimit të tyre).	Blerje e hapësirës mediale në TV Nacionale (për 80 sec)	50 porosi. Nr. i përafërt i sec. është përcaktuar në ofertën financiare Poz. 3.
4	Transmetimi i video-clipeve të bëhet në kohën më të shikuar të TV(para transmetimeve të lajmeve ose menjëherë pas kohës së transmetimit të tyre). Përzgjedhja e TV të bëhet në bazë të rang-listës së shikueshmërisë në nivel nacional.	Blerje e hapësirës mediale në TV lokale (për 80 sec)	20 porosi. Nr. i përafërt i sec. është përcaktuar në ofertën financiare Poz. 4.
5	Transmetimet e audio incizimeve të realizuara nga video-spotet e pozicioneve 1 dhe 2 të bëhen në kohën më të dëgjuar të radiove (para transmetimeve të lajmeve ose menjëherë pas kohës së transmetimit të tyre).	Blerja e hapësirës mediale për radio të ndryshme (për 80 sec)	20 porosi. Nr. i përafërt i sec. është përcaktuar në ofertën financiare. Poz. 5.
6	Draftim /koncept i informatës, dizajni, në gjuhën shqipe dhe shtypje e fletushkës (flyer) 1 faqe në formatin A5	Fletushkë - në gjuhën shqipe	18000
7	Draftim/koncept i informatës, dizajni, në gjuhën serbe dhe shtypje e fletushkës në color (flyer) 1 faqe A5 apo tjera	Fletushkë - në gjuhën serbe	5000
8	Drafti /koncept i informatës, dizajni, dhe shtypje e posterëve (fletushkave) në color në formatin A3 në gjuhët: shqip (700 copë), sasia tjetër (300 copë), në serbisht, turqisht, romë dhe egjiptase.	Fletushkë në formatin A3	1000
9	Incizimi në video i aktiviteteve të ndryshme të ZKM-së në kohëzgjatje prej 20 min .	Video – incizim 20 min.	10
10	Krijimi i Konceptit kreativ për çdo fushatë, event dhe manifestim të organizuar nga ZKM. Dizajn të llogove, për kampanje - Disejnim, krijimi, brendimi i logos-imazhit në bazë të kërkesës së ZKM.	Krijimi i konceptit kreativ.	1

11	Materiale promovuese - Kapela nga tekstili me mbishkrime dhe logo të Institucioneve sipas kërkesës së ZKM-së	Kapela,	1000
12	Materiale promovuese - Bluza të kualitetit të mirë, të madhësive të ndryshme me mbishkrim para dhe mbrapa si dhe me logo sipas kërkesës së ZKM-së	Bluza (T-shirt)	1000
13	Çantë krahu nga tekstili dhe e brenduar në gjuhët e kërkuara nga ZKM-ja me imazh të kampanjës (tote bag – material bez)	Çantë krahu	1000
14	Roll-Up Baner te madhësisë standarde - Draftim/koncept i informatës, dizajnim, (në dy gjuhët zyrtare ne R. Kosovës).Shpërndarja dhe vendosja në pikat e kërkuara nga AK do të bëhet nga OE.	Roll-Up Baner	50
15	Zhvillimi dhe Dizajnimi i strategjisë për dhe shpërndarje (boosting) dhe reklamim në mediat sociale për periudhën kohore (1 vjet) – boosting 2 here ne muaj/24 për vit për çdo llogari ne media sociale në Facebook, Instagram. Targeti: 100000 apo me shume ndjekës! Raport të statistikave ne baza 3 mujore për gjatë periudhës kohore (1 vit)	Blerja e hapësirës sponsorizuese (boosting)	3
16	Detajet: Binë profesionale alumini me dimensione 6.00m x 6.00m e ngritur 1.00 m nga toka për manifestime të ndryshme, me mbulim (çati) te forte (Cerade e zeze dhe e Bardhe) e mbështjella ne 3 anët e bines dhe çatisë me perde te zeza, shkallë ne te dy krahët, dhe dysHEME të mbuluar me tepison. Bina duhet të perfshijel. LED-Monitor, Zerim me fuqi >20.000 Watt, 6 x monitora ne skene, 8 mikrofone me kablllo, 2 mikrofone Wireless, 2 mikrofone pilot, Laptop per Playback, 14 Mbajtes mikrofonash, 2. Kuader shperndares te rrymës me min. 8 priza 1 fazore 220V, 6 x priza industriale 32A 6h, 2 x 63A, 1 x 125A. Ndriqimi I bines duhet te perfshijje: 10 x Fresnel 2 KW me Daylight Filter, 12 x Moving Head Wash B EYE K20, 12 x Beam 16R	Binë	1
17	Karrige për evente të ndryshme , të përshatshme, nga materiali i drurit, plastikes ose metalit. Sasia e përafërt e karrigeve do të jetë deri 1000 copë për huazim një ditor.	Karrige standard për nevoja të takimeve (indoor/outdoor)	1000
18	Stendë -tavinë me logo dhe dizajn/shtyp/përshkrim ne baze te kërkesës se ZKM (përmasat: Standarde për fushata ne sheshe) Transporti, vendosje dhe largimi nga OE.	Stendë -tavinë	10

19	<p>Huazimi i pajisjeve te zerimit për nevojat e ZKM-ës për manifestimet e organizuara ne ambiente te jashtme, Zërimi të jetë profesional me kapacitet >100.000 W i ndarë nga min. 50.000 watt ne secilin krah sipas sistemit LINE ARRAY – LIVE BAND Duhet te ofroj 115 DBA ne 70m' nga skena. Ne cmim duhet te parashikohen: 8 monitora per skene, Skele për varjen e zerimit ne minimum 10m lartesi dhe rezistente ndaj erërave, 18 x Mikrofona me mbajtës te gjate për instrumente (Kitare, Bas Kitare, Klarinet, Tupan, violine, çelo, etj.), 6 x mikrofona WRL për fjalime dhe vokal me mbajtes round base, Miksete digjitale minimum 32 ch. Laptop për playback, Pino elektrike, amplifikator për kitare, amplifikator për bass, tupana (Drums), 2 inxhinier zëri, 3 teknik zëri, gjithashtu komplet kabllimi i sistemit dhe pajisjet përcjellëse për tu lëshuar ne pune.</p>	<p>Zërim (pajisje zerimi) për mbulimin e nevojave te Konferencave ne plato e sheshe dhe ambiente te mbyllura.</p>	2
----	--	---	---

ANEKSI 2. DEKLARATA NËN BETIM

Titulli i aktivitetit : “Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së”

Nr. i Prokurimit: ZK104 23 027 211

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

ANEKSI 3.KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: Zyra e kryeministrit
(më tej “Autoriteti Kontraktues”)

DUKE PASUR PARASYSH SE [emri i operatorit ekonomik] (më tej “Operatori Ekonomik”), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Deklaratë mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet:

PRANDAJ, unë, i poshtënjëshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t’i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

ANEKSI 4.SIGURIA E TENDERIT

Për: **Zyra e Kryeministrit** (në vazhdim: “autoriteti kontraktues”)

Në emër të: [emri dhe adresa e operatorit ekonomik] (në vazhdim “tenderuesi”)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **“Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së”**

Numri i Prokurimit: **ZK104 23 027 211**

Garancion me kërkesë të parë

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t`i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: <shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra> zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderuesi i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
- b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
- c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
 - Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
 - Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
 - Të lidhë kontratë që u përshatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej: <shuma e garantuar> siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyesha që e kërkesë tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlen deri me: <data dhe koha>

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit	
Emri i institucionit financiar	
Adresa	
Data	

ANEKSI 5. KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË

Për: Zyra e Kryeministrit.

DUKE MARRË PARASYSH SE [emri i operatorit ekonomik] (më tej “Operatori Ekonomik”), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referimet në pjesën apo në pjesët e dosjes së tenderit:

PRANDAJ, unë, i poshtënjshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identikuara.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

ANEKSI 6. DEKLARATA PËR THEMELIM TE GRUPIT

Të nënshkruhet nga secili anëtarë i grupi/apo konzorciumi që aplikon

Për: Zyra e Kryeministrit

(në vazhdim: “autoriteti kontraktues”)

Në emër të: [emri dhe adresa e operatorit ekonomik]

(në vazhdim “tenderuesi”)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: “Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së”

Numri i Prokurimit: ZK104 23 027 211.

Kjo shkresë paraqet dhe dëshmon se:

Palët e nënshkuara me poshte:

1. Shkruaj emrin e plotë të OE:		I regjistruar në:	
2. Shkruaj emrin e plotë të OE:		I regjistruar në:	

shtu rreshta sipas nevojës ...

Hijne ne bashkëpunim / konzorcium , për qëllim të këtij tenderi me titull: “Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së” me numër të prokurimit ZK104 23 027 211. Palet konfirmojne se:

- janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i ipet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;
- Palët deklarojnë qartë se si anëtarë të grupit duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
- Palët deklarojnë qartë se si anëtarë të grupit janë **të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.
- Palët deklarojnë qartë se të gjithë anëtarët e grupit autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit dhe do të jetë: (Emri dhe Mbiemri) personi i **autorizuar** për të nënshkruar formularin e tenderit, kontratën dhe qdo dokument tjetër që nuk është në kundërshtim me kërkesat e kësaj dosje të tenderit ose LPP-se në emër të Grupit/Konzerciumit.

Emri i Operatorit Ekonomik (lider)	
Emri & Mbiemri (Përfaqesuesi i autorizuar)	
Data/Nenshkrimi / Vula	

Përfaqesuesi i autorizuar do të nënshkruaj formularin e tenderit dhe kontratën dhe ndonje dokument tjetër që nuk është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit ose LPP-se.

Anetaret e tjere te grupit:

Emri i Operatorit Ekonomik	
I përfaqësuar nga: Emri Mbiemri	
Data/Nenshkrimi / Vula	

Shtu tabela sipas nevojës.

PJESA B:DRAFT KONTRATA²& KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA PJESA I E KONTRATËS:DRAFT KONTRATA

[Emri i Autoritetit Kontraktues], (në vazhdim “Autoriteti Kontraktues”), në njërin anë; dhe
[Emri Ofruesit të Shërbimeve], (në vazhdim “Ofruesi i Shërbimeve”), në anë tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara më poshtë:

Titulli: “Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së”

Numri i prokurimit: **ZK104 23 027 211**

Neni 1. Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve: “Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së”.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje, p.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “parasinë” tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin I është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorin shërbimet e përmendura në I.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me [shëno datën] dhe përfundon në datën [shëno datën]

Neni 2. Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë [shëno numrin] ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë [shëno vendin e kryerjes].

[Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese shëno]

[Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 4 të të Dokumentit Parakualifikues.]

Neni 3. Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare. Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është [shëno vlerën totale] Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është [shëno përqindjen].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4. Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Aneksi I -Specifikimet Teknike;
- (e) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (f) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

²Para nënshkrimit të Kontratës “kjo Draft Kontrate” duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5. Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Dfruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Dfruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri & Mbiemri:	
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Emri & Mbiemri:	
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Për Dfruesin e Shërbimeve

Emri & Mbiemri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS-KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1.Përkufizimet

- 1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Dfruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Dfruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Dfruesit të Shërbimeve.
- 1.3 “**Dfrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Dfruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Dfruesi i Shërbimeve.
- 1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Dfruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2. Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3. Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Dfruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tre të.
- 3.2 Dfruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
 - a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Dfruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Dfruesit të Shërbimeve siguruesve të Dfruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Dfruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Dfruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4.Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Dfruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Dfruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Dfruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Dfruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktuar pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.
- 4.3 Autoriteti kontraktues nuk nje lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.
- 4.4 Dfruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Dfruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Dfruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5. Tatimi

- 5.1 Dfruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.
- 5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.
- 5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.
- 5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Dfruesi i Shërbimeve.

Neni 6.Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

- 6.1 Dfruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.
- 6.2 Dfruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Dfruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7.Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Dfruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Dfruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Dfruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Dfruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8. Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi “forcë madhore” do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruar ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Dfruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Dfruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Dfruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9. Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Dfruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Dfruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze të realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Dfruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Dfruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Dfruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Dfruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;

(f) Dfruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;

(g) Dfruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Dfruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Dfruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Dfruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Dfruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Dfruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmblyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Dfruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Dfruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Dfruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Dfruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Dfruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Dfruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Dfruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10. Ndërprerja e Kontratës nga Dfruesi i Shërbimeve

10.1 Dfruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Dfruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Dfruesi i Shërbimeve është i paafët të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Dfruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Dfruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Dfruesit të Shërbimeve.

Neni 11. Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12. Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13. Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

d. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14. Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15. Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16. Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17. Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18. Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19. Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë të kërkojë kompensime:

- a) dëmet dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme: ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20. Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përqipen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22. Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezanti met e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES: KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Transferimi	3	Autoriteti Kontraktues/Njesive kërkuese në këtë nen i referohet Zyrës së Kryeministrit, Transferimi lejohet vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga Kontraktuesi në AK.
Nen-kontraktimi	4	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Zyrës së Kryeministrit. Nënkontraktimi lejohet gjatë fazës së implementimit vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK..
Dhënia e dokumenteve	5	Autoriteti Kontraktues obligohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës ta hartoj Planin e Menaxhimit të Kontratës.
Obligimet e përgjithshme.	7	Kontraktuesi do të emërojë një përfaqësues - Menaxher, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Menaxheri apo zëvendësi i tij duhet të jetë në dispozicion çdo herë që kërkohet dhe do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.
Ndërprerja e Kontratës nga AK	9.1	Sipas kriterëve të përcaktuara në KPK
Ndërprerja e Kontratës nga OE	10	Sipas kriterëve të përcaktuara në KPK
Siguria e ekzekutimit	14.1	Ofruesi i shërbimeve, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzojë sigurimin e ekzekutimit të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me kohëzgjatje prej 25 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.
Parimet të përgjithshme të pagesave	16	Faturat mund të dorëzohen në formë fizike ose elektronike. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro dhe do të realizohen konform Nenit 16 të KPK
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Autoritetet Kontraktuese rezervon të drejtën për të kontrolluar çdo dokument që përshkruan kërkesat e kësaj kontrate gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës dhe inspektimi mund të realizohet drejtpërdrejt tek zyrat e ofruesit të shërbimeve .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore , përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë Zyrtarët e Autoritetit Kontraktues dhe Zyrtarët përgjegjës të Ofruesit të Shërbimeve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën kompetente, në pajtim me ligjin e Kosovës.

PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT

[Me logon e institucionit financiar që e jep sigurinë]

Për: [emri i autoritetit kontraktues]

(në vazhdim: “autoriteti kontraktues”)

Në emër të: [emri dhe adresa e operatorit ekonomik]

(në vazhdim “operatori ekonomik”)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: “Shërbime të informimit publik për nevojat e ZKM-së”

Numri i Prokurimit: ZK104 23 027 211

Garancion me kërkesë të pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t`i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: <shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra> zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: <shuma e garantuar> sig është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin “e pranimit”.

Kjo siguri vlen deri me: <data dhe koha>

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i institucionit financiar	
Adresa	
Data	

PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Kontakti	
Telefoni	
Faks	
E-mail	
Numri i TVSH	

BANKA	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Llogaria Bankare	
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

<u>VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)</u>

<u>DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)</u>